



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr.1835/5Prot

Tiranë, më 23.12.2022

**VENDIM**

**Nr.65, datë 23.12.2022**

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesja, znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesat nr.1834 Prot., dhe nr. 1835 Prot., datë 26.10.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Kulturës” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në përputhje me shkronjën “ç” të nenit 65 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duke qenë se ankesat lidhen me të njëjtat fakte, bazë ligjore dhe i drejtohen të njëjtit Autoritet Publik, Komisioneri çmon trajtimin e tyre në një vendim të vetëm.

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 04.10.2022, ka kërkuar t’i vendosen në dispozicion relacionet përfundimtare të Vendimeve të Këshillit të Ministrave të miratuara gjatë katër - mujorit të parë të vitit 2022, me propozim të Ministrit të Kulturës, si vijon:

1. Nr. 42, datë 19.1.2022 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës të pronës, me emërtimin “Teatri Kombëtar i Kukullave”, me numër pasurie 6/163, zona kadastrale 8380, Tiranë”;

2. Nr. 61, datë 26.1.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 737, datë 17.9.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale””;
3. Nr. 62, datë 26.1.2022 “Për lirimimin nga detyra të drejtorit të Galerisë Kombëtare të Arteve”;
4. Nr. 99, datë 09.2.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr.146, datë 10.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Muzeut të Arsimit Korçë””;
5. Nr. 138, datë 2.3.2022 “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për projektin “EU4CULTURE””;
6. Nr. 151, datë 11.3.2022 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave të aplikimit, të rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e artit e të kulturës”;
7. Nr. 231, datë 13.4.2022 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës të pasurisë nr.1/100, në zonën kadastrale 8150, dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë për këtë pasuri”;
8. Nr. 287, datë 29.4.22 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për Bashkinë Tiranë, për financimin e projektit “Tirana, kryeqyteti evropian i rinisë 2022””.

Ndërkohë, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 10.10.2022, ka kërkuar t’i vendosen në dispozicion relacionet përfundimtare të Vendimeve të Këshillit të Ministrave të miratuara gjatë periudhës Maj - Shtator 2022, me propozim të Ministrit të Kulturës, si vijon:

1. Nr. 306, datë 11.5.2022, “Për procedurat që ndiqen për financimin e projekteve artistike”;
2. Nr. 381, datë 1.6.2022, “Për disa shtesa në vendimin nr. 721, datë 5.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifës së biletave të Teatrit Kombëtar””;
3. Nr. 420, 15.6.2022 “Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura”;
4. Nr. 438, datë 22.6.2022 “Për miratimin e planit të menaxhimit të integruar të Ansambllit Historik të Pallatit të Brigadave”;
5. Nr. 439, datë 22.6.2022 “Për lirimimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor”;
6. Nr. 560, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e procedurave publike për dhënie në administrim indirekt të pasurive kulturore personave fizikë ose juridikë, publikë ose private”;
7. Nr. 561, datë 29.7.2022 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Ministria e Kulturës, të një pjesë të pasurisë nr. 4/867, zona kadastrale 8270, me emërtim “Garda e Republikës,

*Garnizon”, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 406, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave”.*

Autoriteti Publik, lidhur me kërkesën e parë për informacion, nëpërmjet e-mail-it datë 25.10.2022, ka kthyer përgjigje duke cituar ndër të tjera se: “... bazuar në ligjin nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” përcaktohet se projektaktet së bashku me relacionin shpjegues depozitohen në Këshillin e Ministrave për miratim. Për këtë kërkesë sugjerojmë t’i drejtoheni Kryeministrisë”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja pretendon se: “... Autoriteti Publik përbën një shkelje të dyfishtë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si në aspektin e refuzimit të vënies në dispozicion të dokumentacionit zyrtar që autoriteti e disponon vetë, ashtu edhe në mos-dërgimin e kërkesës në autoritetin përgjegjës, në përputhje me dispozitat e LDI dhe Kodit të Procedurave Administrative në rastin kur faktikisht nuk e disponon dokumentacionin.

*Relacioni është një dokument zyrtar që shoqëron projekt VKM-në. Si i tillë, ai mban stemën e institucionit propozues dhe nënshkrimin e drejtuesit të tij. Mes të tjerash, në të përfshihen mendimet dhe vërejtjet institucionale të ministrive dhe institucioneve të interesuara, si edhe shpjegimet për marrjen ose jo parasysh të tyre. Dokumentet zyrtare u nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që përcaktohen specifikisht në ligjin për të drejtën e informimit ose në ligje të tjera të posaçme. Relacioni shoqëruar i projekt VKM-së nuk rezulton të jetë subjekt i asnjë kufizimi.*

*Rrjedhimisht, relacioni përfundimtar që shoqëron projekt VKM-në, si një dokument zyrtar, që nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi ligjor, përbën një informacion publik, i cili duhet vënë në dispozicion sipas kërkesës për informim në ushtrim të një të drejte kushtetuese. Refuzimi për vënien në dispozicion të këtij informacioni është një akt i paligjshëm, i cili shkel të drejtën kushtetuese për informim të çdo qytetari.”*

Në vijim, ankuesja kërkon nga Zyra e Komisionerit, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të cituar si më sipër.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në to, vlerësoi se ankesat përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjeve, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresat nr. 1834/1 prot., dhe nr. 1835/1 Prot., datë 02.11.2022 kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 04.11.2022, ka rikonfirmuar qëndrimin duke sqaruar ndër të tjera se: “... për kërkesën e Znj. \_\_\_\_\_, Ministria e Kulturës me shkresën nr. 5987 Prot., datë 31.10.2022, ka kthyer përgjigje.

Pas vlerësimit, Ministria e Kulturës, në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ku përcaktohet se projektaktet së bashku me relacionin shpjegues depozitohen në Këshillin e Ministrave për miratim, ka sugjeruar që znj. Ilias ti drejtohet Kryeministrit për informacionin e kërkuar”.

Në këto kusht, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: “Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, si edhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 1835/4 Prot., datë 02.12.2022, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seancë e cila u zhvillua me datë 07.12.2022 në mungesë të ankueses, e cila me e-mail-in datë 07.12.2022, bëri me dije mbi pamundësinë për pjesëmarrjen fizike të saj.

Ankuesja gjithashtu sipas kërkesës së Zyrës së Komisionerit, vendosi në dispozicion parashtrimet me shkrim mbi të cilat i qëndroi ankesave dhe mbështeti vijimin e ankimeve.

Autoriteti Publik, pas përfundimit të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 6435/1 Prot., datë 07.12.2022, rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, duke bërë me dije se: “...Ministria e Kulturës nuk e ka refuzuar dhënien e informacionit kërkuar, por e ka orientuar që ti drejtohet Kryeministrit, duke qenë se dokumentacioni i kërkuar përbën një akt administrativ final i cili administrohet nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, përcaktohet se projektaktet së bashku me relacionin shpjegues depozitohen në Këshillin e Ministrave për miratim”.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se argumentet e dhëna nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.

Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Kulturës është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Lidhur me argumentin e Autoritetit Publik se Ministria e Kulturës, në zbatim të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ku përcaktohet se projektaktet së bashku me relacionin shpjegues depozitohen në Këshillin e Ministrave për miratim, ka sugjeruar që znj. Ilias ti drejtohet Kryeministrit

për informacionin e kërkuar, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron. Konstatohet se, në përgjigjen e dhënë, Autoriteti Publik ka sugjeruar kërkuuesen t'i drejtohet Kryeministrisë, por nuk rezulton që të ketë trajtuar kërkesën për informacion, në bazë të pikave 2 dhe 3 të nenit 12 të LDI, në të cilën parashikohet se:

2. *“Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuuesin.*

3. *Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuuesin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”*

Gjithashtu, po në kuptim të dispozitës së sipërcituar, Autoriteti Publik vetëm në rastet kur nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ia dërgon kërkesën për informacion autoritetit publik kompetent, por në përgjigjen e dhënë, konstatohet se Autoriteti Publik nuk është shprehur nëse e disponon ose jo informacionin e kërkuar. Megjithatë, në kushtet kur Autoriteti Publik është vetpropozues i projektaktit, rrjedhimisht informacioni i kërkuar është prodhuar dhe duhet të disponohet nga ky Autoritet Publik.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar në parim përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Po ashtu, Autoriteti Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar duhet të mbajë në konsideratë parashikimet sipas nenit 17 të LDI, konkretisht në pikën 6 të tij përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

Theksojmë se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në pikën 3 të nenit 3 të LDI parashikohet se, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesave nr. 1834 Prot., dhe nr. 1835 Prot., datë 26.10.2022 nga znj. kundër Autoritetit Publik “Ministria e Kulturës”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesave për informacion datë 04.10.2022 dhe 10.10.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 06.01.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 23.12.2022.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**